



PROMOTING  
PRIVATE SECTOR  
EMPLOYMENT

*Sektori për Përpunimin e Ushqimit  
– Raporti për Strategjinë e Tregut  
Shkurt, 2015*

# *Përmbajtja*

<i>Rreth PPSE</i> . . . . .	<i>3</i>
<i>Përshkrim i shkurtër i sektorit për përpunimin e ushqimit</i> . . . . .	<i>6</i>
<i>Dinamika e sektorit</i> . . . . .	<i>7</i>
<i>Analiza e Problemit me Analizën e Intervenimit të Kornizës Logjike</i> . . . . .	<i>8</i>
<i>Zinxhiri i vlerës së përpunimit të ushqimit</i> . . . . .	<i>9</i>
<i>Vizioni i propozuar për ndryshim</i> . . . . .	<i>10</i>
<i>Intervenimet</i> . . . . .	<i>11</i>
<i>Arritjet e deritanishme</i> . . . . .	<i>12</i>
<i>Pozita e gruas në përpunimin e ushqimit</i> . . . . .	<i>14</i>
<i>Qeverisja në nivelin e sektorit (përpunimi i ushqimit)</i> . . . . .	<i>15</i>
<i>Minoritetet</i> . . . . .	<i>15</i>

# Rreth PPSE



Projekti Promovimi i punësimit në sektorin privat (**PPSE**) në Kosovë i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë (SDC), dhe implementohet nga **Swisscontact** (si partner udhëheqës), **Instituti Riinvest** dhe **PEM Consult** ka për qëllim të ndihmoj ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (në tekstin vijues NVM-të) të cilat operojnë në sektorë ekonomik konkurrues, ku politikat publike më mirë i përgjigjen nevojave të sektorit privat, dhe të siguroj punësim të rritur dhe qëndrueshëm për gratë dhe burrat. Partnerët kryesor nacional janë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (**MTI**) dhe Oda Ekonomike e Kosovës. PPSE përdor qasjen për Zhvillimin e sistemit të

tregut (MSD), (më herët e njohur si Tregjet për të varfrit apo qasja M4P), që në mënyrë specifike fokusohet në facilitimin e tregut përmes modeleve të reja të biznesit për të siguruar ndryshim të shkallës së gjerë dhe të qëndrueshëm.

Rezultatet/objektivat e programit janë:

- 1) rritja e produktivitetit, të ardhura shtesë dhe gjenerimi i punësimit;
- 2) Ndikimi i mirë-krijuar dhe organizuar i politikës sektoriale të NVM;
- 3) Reduktimi i barrierave për gratë për të pasur qasje në punësim të qëndrueshëm përderisa fuqia e tyre vendim-marrëse është rritur.



Në sektorët e përzgjedhur, NVM-të rrisin produktivitetin e tyre dhe krijojnë të ardhura shtesë dhe punësimin, duke i mundësuar ofruesve të shërbimeve dhe furnizuesve që të zhvillojnë produkte të avancuara dhe të qëndrueshme (mallra dhe shërbime) dhe praktika prodhimi. Për më tepër, PPSE do të i mundësoj ofruesve të shërbimeve dhe furnizuesve që të ofrojnë procese të sistemit të tregut në zinxhirët e veçantë të vlerave.

Sa i përket qeverisjes së zhvillimit të sektorit privat, PPSE do të dizajnojë intervenime specifike me të cilat do të përkrah organizimin e brendshëm të NVM-ve dhe organizimin e sektorit në sektorët e përzgjedhur të projektit. Transparenca, llogaridhënia dhe efikasiteti janë parimet themelore të qeverisjes së mirë që fillimisht do të trajtohen për të synuar iniciativa advokuese dhe ndryshime të politikave.

Në nivelin e ndikimit ekziston një boshllëk i konsiderueshëm në punësim midis grave dhe burrave. Gratë në Kosovë paraqesin një burim të pashfrytëzuar, janë të nën-punësuar dhe të nën-përfaqësuar si pronare biznesi apo menaxhere. Për të zvogëluar pabarazinë gjinore dhe për të ofruar përfitim të barabartë për të dy gjinitë, rezultati nga Fuqizimi Ekonomik i Grave dhe strategjia paraqesin gur themelin e qasjes. Si rezultat, qasja e avancuar në punësim dhe vendim marrje për gratë është çelësi i punësimit fitimprurës dhe të qëndrueshëm.

Në bazë të rezultateve të pritura, shtatëqind e pesëdhjetë NVM nga sektorët e zgjedhur rrisin produktivitetin e tyre dhe krijojnë të ardhura shtesë dhe punësimin. Prandaj programi ka për qëllim:

- Rritjen e të ardhurave neto prej **CHF 1.900.000** nëpër sektorët e zgjedhur

- Krijimin e **800** vendeve të punës me orare të plotë, **30%** për gratë.

Fillimisht programi fokusohet në dy sektorë kryesorë: **sektorin e përpunimit të ushqimit** (konkretisht përpunimin e pemëve dhe primeve dhe nën sektorët e produkteve pyjore jo nga druri) **sektorin e turizmit** (të përqendruar në Kosovën perëndimore), **sektorin e prodhimit** (të përzgjedhur gjatë fazës së implementimit). Të gjithë sektorët ofrojnë potencial të madh për përmirësime për punësim dhe shfrytëzim të aseteve përmes largimit të pengesave të zbuluara përmes analizës sonë të alfa deri te omega të sektorëve. Projekti PPSE ka iniciuar fazën fillestare në tetor 2013. Faza e implementimit ka filluar në nëntor të vitit 2014 dhe do të vazhdojë deri në nëntor 2017. Pilot intervenime janë implementuar për sektorin e turizmit dhe përpunimit të ushqimit. Veç kësaj, projekti ka themeluar **fondin e mundësive** - i cili shërben si instrument shtesë për të arritur rritje dhe krijuar punësim për ndërmarrësit e Kosovës. PPSE përdor kornizë të fortë të Monitorimit dhe Menaxhimit të Rezultateve (MRM) për të vendosur të dhëna bazë, siguruar cilësi të rezultateve, definuar indikatorët, vlerësuar ndikimin, dhe të siguruar të dhëna raportimit për çdo intervenim.

Projekt PPSE është programi **i parë** në Kosovë që përdor **DCED (Komitetin e Donatorëve për Zhvillimin e Ndërmarrjeve)** standardin për sigurimin e cilësisë. Integrimi i grave, qeverisja, dhe minoritetet si çështje të ndërlidhura janë kryesore në të gjitha intervenimet. Projekti do të ndajë shënimet sipas gjinisë dhe etnive, dhe një përpjekje e veçantë do të bëhet për të përfshirë NVM-të Serbe.

# *Përshkrim i shkurtër i sektorit për përpunimin e ushqimit*

Sektori i bujqësisë përbën mesatarisht 42% të punësimit të Kosovës, sipas Agjencisë për Statistika të Kosovës (KAS).

Bujqësia, që përbënte 25% të GDP të Kosovës në vitet 1980ta dhe vitet e hershme të 1990ta, zvogëloi pjesën e saj në 14% të GDP në vitin 2011. GDP e Kosovës per capita përbën € 2,650, që është rreth 10.6% të BE-27 mesatarja.

Bilanci i tregut të prodhimeve bujqësore të Kosovës është negativ. Vlera e eksporteve Kosovare ka qenë €28.9 mio në vitin 2013, është shkurtuar për €527.4 mio në improte, duke përfaqësuar vetëm 5.4% të vlerës së importeve<sup>1</sup>. Në mes të viteve 2007 dhe 2013 eksportet bujqësore të Kosovoës janë rritur për 51%, prej €19.1 mio në €28.9 mio në vitin 2013. Për periudhën e njëjtë, vlera e importeve bujqësore është rritur për 50%.

Hulumtimi i PPSE se potenciali më i lartë për rritje dhe punësim në sektorin e përpunimit të ushqimit qëndron në nën-sektorin për përpunimin e pemëve dhe perimeve. Nën-sektori për përpunimin e pemëve dhe perimeve është dinamik, duke siguruar mesatarisht 50,000 vende pune me kohë të plotë.<sup>2</sup> Si rezultat, ky sektor është prioritet i lartë për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës (MBPZHRK).

Kërkesat për pemë dhe perime të përpunuara në Unionin Evropian janë rritur dukshëm viteve të fundit në përgjigje të konsumatorëve të shumtë për një kohë të shkurtër. Prandaj, prodhimi i pemëve dhe perimeve të përpunuara në Bashkimin Evropian (BE) është rritur për 85% në mes të viteve 2005 dhe 2010<sup>3</sup>. Shtetet e BE kanë shënuar një normë të rritjes mesatare prej 4.2% të importeve për pemë dhe perime të përpunuara për më shumë se një dekadë<sup>4</sup> pasi që shtetet e regjionit kanë rritur eksportet për t'iu përgjigjur kërkesave.

Kosova ka potencial të madh që të plotësojë këto kërkesa të mëdha. Qendra për Promovimin e Importeve nga Shtetet në Zhvillim (CBI) mban statistika për importet e BE-së të pemëve dhe perimeve të përpunuara nga shtetet në zhvillim. CBI ka shënuar një rritje prej 48% në periudhën prej 2005 dhe 2010. Përkundër mundësive të

tregut, kompanitë përpunuese në Kosovë dështojnë të përmbushin edhe kërkesat vendore për pemë dhe perime të përpunuara. Vlerësohet se rreth 70% e pjesës së tregut përbëhet nga prodhimet e importuara.

Pavarësisht nga trendi në rritje i investimeve në përpunimin e ushqimit nëpër BE, industria e përpunimit në Kosovë mbetet në tranzicion e sipër. Nën-sektori i pemëve dhe perimeve përbëhet nga kompani të vogla dhe të mesme të përpunimit. Ka dhjetëra kompani të mëdha dhe të mesme për përpunim në Kosovë, që përpunojnë 9,000 ton në vit (80% perime dhe 20% pemë), me një seri relativisht të vogël të prodhimeve. Ka gjithashtu edhe disa shoqata të grave që prodhojnë sasi të vogla për shitje përmes kanale të ndryshme të tregut, duke u përqendruar në të ashtuquajturit prodhime "shtëpiake".

Kualiteti i pemëve dhe perimeve në Kosovë është përmirësuar, që rezulton nga mbështetja e zgjeruar dhe zhvillimi i faktorëve të tregut. Furnizuesit kanë përmirësuar ofertat e tyre, aplikimi i qendrave të grumbullimit dhe shërbimet këshilluese kanë përmirësuar sistemin e furnizimit.

Fermerët, megjithëkëtë përqendrohen më shumë në prodhimin e varieteteve të freskëta se sa në zgjerim për të plotësuar kërkesat e përpunimit, pasi që bashkëpunimi në mes të sektorëve është momentalisht i dobët. Zinxhirët e shitjes me pakicë janë faktorë shumë të fuqishëm në sektorin e përpunimit të ushqimit, që imponojnë kushte të rrepta ndaj kompanive të përpunimit të ushqimit që përfshijnë vonesa në pagesa. Produktet financiare që mund të ngadalësojnë presionet ndaj fermerëve dhe përpunuesve të ushqimit janë të shtrenjta dhe jo praktike në këtë kohë. Kompanitë përpunuese dhe faktorët tjerë të tregut gjithashtu ballafaqohen me pengesa ligjore dhe rregullative (për shembull ligjet anti-dumping). Përkundër shumë problemeve, kompanitë përpunuese janë duke e përmirësuar konkurrencën, me kompanitë Kosovare që me sukses janë duke eksportuar në tregjet e BE-së dhe ato regjionale.

## Dinamika e sektorit

Edhe me preferencat e konsumatorëve për produkte vendore, pjesa më e madhe e pemëve dhe perimeve të përpunuara po importohen, si rezultat i konkurrencës së kufizuar të përpunuesve vendor . Njëkohësisht, përpunuesit po eksportojnë prodhimet e veta, duke synuar tregun e diasporës Kosovare në BE. Përpunuesit e Kosovës kanë treg potencial në të dyja, tregun lokal për zëvendësimin e importit dhe tregun e eksportit për rritje të eksportit. Këto faktorë e bëjnë intervenimin e projektit PPSE një mundësi për të kontribuar në dinamikën ekzistuese për efekt maksimal.


Kosova ka dhjetë përpunues të pemëve dhe perimeve ; nga dhjetë, katër merren me përpunimin e perimeve, dhe një merret me përpunimin e pemëve, kurse pesë të tjerat merren me të dyja. Përveç

përpunuesve të mëdhenj janë edhe disa përpunues të vegjël, kryesisht të udhëhequr nga shoqatat e grave, që merren kryesisht me përpunimin e perimeve "shtëpiake" që synojnë kanale kamare tregu. Është në rritje tregu për këto prodhime në rajonet urbane.

Përkundër trendit në rritje në prodhimin e pemëve dhe perimeve të përpunuara, hapësira në mes të kapaciteteve dhe prodhimeve aktuale është duke u ngushtuar (shih Figurën më poshtë). Hapësira aktuale është për shkak të përpunuesve të mëdhenj që aktualisht përdorin vetëm 20% të kapaciteteve të veta.

Tetë nga dhjetë përpunues përfaqëson (dy raportohen si konfidencial) përafërsisht 5,7 ton të prodhimeve të përpunuara në vitin 2013.

### Përpunimi vjetor dhe kapacitetit përpunues i pemëve & perimeve në Kosovë, për vitet 2011-2013 (në ton)



## Analiza e Problemit me Analizën e Intervenimit të Kornizës Logjike (mjete MSD (ish M4P))

(1) Analiza e Problemit	(2) Shkaku	(3) Shërbimet dhe (4) BEE	(5) Dobësitë e Shërbimeve / shkaqet ndërlidhëse	(6) Intervenimi	(7) Aktorët e Tregut
<b>PËRPUNIMI I MADH FORMAL</b>					
1. Furnizimi i ulët me prodhime të përpunimit	Përpunuesit nuk mund të sigurojnë lëndën e parë në mënyrë të rregullt	Sigurimi i shërbimit të grumbullimit të shërbimeve	Mungesa e shërbimeve ndihmëse / shërbimeve të grumbullimit	<b>Intervenimi 2 –</b> Promovimi i sistemit të grumbullimit	Qendrat e grumbullimit; fermerët; kompanitë e përpunimit
	Prodhimi është i Përqendruar në treg të freskët	Sigurimi i varieteteve për industrinë e përpunimit	Sigurimi i varieteteve industriale nga ana e furnizuesve; Shërbime të ulëta të grumbullimit për industrinë e përpunimit	<b>Intervenimi 1–</b> Aplikimi i Varieteteve të Perimeve Industriale	Furnizuesit; qendrat e grumbullimit; kompanitë e përpunimit; fermerët
	Menaxhment dhe planifikim i dobët nga ana kompanive të përpunimit	Mungesë e kapaciteteve të menaxhmentit të brendshëm dhe sigurim i menaxhmentit dhe shërbimeve të planifikimit	Kompanitë e përpunimit kanë kapacitete të kufizuara në menaxhment- menaxhmenti i mesëm mungon; Menaxhmenti dhe shërbimet e planifikimit konsiderohen të shtrenjta	<b>Intervenimi 7 –</b> Aplikimi i planifikimit të përbalueshëm/shërbimet e menaxhmentit	Kompanitë për konsultime biznesi; kompanitë e përpunimit
2. Kompanitë e përpunimit nuk i shfrytëzojnë kapacitetet mjaftueshëm	Kompanitë e përpunimit përballen e problem të likuiditetit	Sigurimi i shërbimeve financiare të realizueshme	Shërbimet bankare nuk i tejkalojnë kufizimet e likuiditetit; prodhimet financiare janë të shtrenjta	<b>Intervenimi 4 -</b> Aplikimi i prodhimeve financiare të realizueshme	Bankat dhe institucionet financiare; kompanitë e përpunimit; zinxhirët e shitjes me pakicë
	Përpunuesit nuk kontratojnë furnizimin e lëndës së parë para kohe	Sigurimi i shërbimeve të grumbullimit të prodhimeve	Mungesë e shërbimeve ndihmëse/shërbimeve të grumbullimit	<b>Intervenimi 6 –</b> Promovimi i plasimit të prodhimeve të përpunuara vendore në zinxhirin e shitjes me pakicë	Qendrat e grumbullimit; fermerët; kompanitë e përpunimit
	Qasja në tregun me pakicë është i vështirë; prodhimet vendore kanë plasman inferior të prodhimeve	Qasja në tregun me pakicë; sigurimi i hapësirës së mjaftueshme dhe promovimi i duhur	Shitësit me pakicë ofrojnë kushte të pavolitshme ndaj përpunuesve vendor	<b>Intervenimi 8 –</b> Aplikimi i Prodhimeve të Hulumtimit të Tregut të Përbalueshëm	Zinxhirët e shitjes me pakicë, kompanitë e përpunimit; shoqata e përpunuesve
	Kompanitë e përpunimit ballafaqohen me kërkesa të pasigurta për prodhimet e veta; fuqia e negociimit është e ulët	Sigurimi dhe qasja në hulumtimin e tregut dhe shërbimet e tregut	Shërbimet e shtrenjta dhe mosgatishmëria për të paguar	<b>Para-Intervenimi –</b> Sigurimi i Ekspertëve afat shkurtër për Teknologji Ushqimore	Kompanitë për konsultime biznesi; kompanitë e përpunimit




4. Diversifikimi i ulët i prodhimit	Mungesë e kapaciteteve teknike njerëzore: Teknolog të ushqimit	Sigurimi dhe qasja ndaj shërbimeve të teknologjisë së ushqimit	Universitetet dhe qendrat profesionale edukative në Kosovë nuk kanë programe për teknologji të ushqimit	<b>Para-Intervenimi –</b> Sigurimi i Ekspertëve afat shkurtër për Teknologji Ushqimore	Ekspertë të teknologjisë ushqimore ; kompanitë e përpunimit
	Njohuritë e kufizuara të tregut dhe iniciativave të tregut	Sigurimi dhe qasja e hulumtimit të tregut dhe shërbimeve të tregut	Shërbimet e shtrenjta dhe mosgatishmëria për të paguar	<b>Intervenimi 8 -</b> Aplikimi i Prodhimeve të Hulumtimit të Tregut të Përballeshëm	Kompanitë për konsultime biznesi; kompanitë e përpunimit
3. Kualiteti i pasigurtë i prodhimeve të përpunuara vendore	Mungesë e kapaciteteve teknike njerëzore: Teknolog të ushqimit	Sigurimi i qasjes në shërbime të teknologjisë së ushqimit	Universiteteve edhe qendrave arsimore profesionale të arti zanateve në Kosovë iu mungon teknologjia e ushqimit	<b>Para-intervenimi –</b> Sigurimi i ekspertëve afat shkurtër mbi teknologjinë e ushqimit	Ekspert teknolog të ushqimit; kompanitë e ushqimit
	Mungesë e standardeve të kualitetit dhe sigurisë	Sigurimi i shërbimeve të certifikimit të standardeve të kualitetit dhe sigurisë	Trupat profesionale private dhe ndërkombëtare për certifikimin e kualitetit dhe sigurisë nuk janë prezente në Kosovë	<b>Intervenimi 9 –</b> Aplikimi i trupave private të certifikimit	Organe private të certifikimit dhe ekspert; kompanitë e përpunimit
5. Tregjet e reja të eksportit	Kompanitë e përpunimit kanë njohuri të kufizuara për mundësitë e reja të tregjeve të eksportit	Sigurimi dhe qasja në hulumtimin e tregut dhe shërbimet e tregut	Shërbimet e shtrenjta dhe mosgatishmëria për të paguar	<b>Intervenimi 8 –</b> Aplikimi i Prodhimeve të financiarisht të përballeshme të Hulumtimit të Tregut	Kompanitë për konsultime biznesi; kompanitë e përpunimit
	Mungesa e standardeve të kualitetit dhe sigurisë	Sigurimi i shërbimeve të certifikimit të standardeve të kualitetit dhe sigurisë	Trupat profesionale private dhe ndërkombëtare për certifikimin e kualitetit dhe sigurisë nuk janë prezente në Kosovë	<b>Intervenimi 9 –</b> Aplikimi i trupave private të certifikimit	Trupat private të certifikimit dhe ekspertët; kompanitë e përpunimit
	Promovimi në tregjet ndërkombëtare përmes panajreve është i dobët; Mungon organizimi dhe promovimi kolektiv	Qasja në dhe sigurimi i promovimit në panajret ndërkombëtare	Pak iniciativa nga institucionet publike dhe koordinim i dobët i përpunuesve	<b>Intervenimi 5 –</b> Promovimi i Prodhimeve të Përpunuara të Kosovës në Tregjet Ndërkombëtare	Agjencia e Kosovës për Promovimin e Investimeve (IPAK); Ministria e Tregtisë; Shoqata e përpunuesve; Kompanitë e përpunimit



PËRPUNIMI I SHKALLËS SË VOGËL					
6. Kualiteti jo i regullt	Kompanitë e vogla të përpunimit kanë njohuri teknike të kufizuara për teknologjinë ushqimore	Sigurimi i trajnimeve për teknologjinë ushqimore; qasje te teknologët bujqësor	Kompanitë e vogla nuk kanë mundësi të paguajnë shërbime profesionale për teknologji ushqimore	<b>Intervenimi 3 –</b> Aplikimi i Distributorëve Privat Lokal për Përpunuesit e vegjël (Shërbimet trajnuese të organizuara me shërbimet e distribuimit)	Distributorët privat; përpunuesit e vegjël; ekspertët e teknologjisë ushqimore;
	Kualiteti i dobët dhe standardet e sigurisë	Sigurimi i trajnimeve standardet e sigurisë dhe të kualitetit dhe standardizimi i prodhimeve	Kompanitë e vogla të përpunimit nuk kanë mundësi të paguajnë për certifikimin e kualitetit dhe sigurisë	<b>Intervenimi 3 –</b> Aplikimi i Distributorëve Privat Lokal për Përpunuesit e Vegjël ( Shërbimet trajnuese të organizuara me shërbimet e distribuimit )	Distributorët privat; përpunuesit e vegjël; ekspert të kualitetit dhe sigurisë;
7. Segmenti i ri i tregut	Përpunuesit e vegjël në përgjithësi shesin qoftë përmes panairove ose kërkesës direkte, në pamundësi të kenë qasje në tregun e shitjes me pakicë	Sigurimi i shërbimeve të distribuimit për të pasur qasje në tregun e shitjes me pakicë	Nuk ka distributor privat për të punuar me përpunuesit e vegjël që ofrojnë prodhime “shtëpiake”	<b>Intervenimi 3 –</b> Aplikimi i Distributorëve Privat Lokal për Përpunuesit ve Vegjël	Distributorët privat; përpunuesit e vegjël, zinxhirët e shitjes me pakicë;



# Zinxhiri i vlerës së përpunimit të ushqimit



## Vizioni i propozuar për ndryshim

Bazuar në të dhënat e hulumtimit tonë, Vizioni për Ndryshim i nën-sektorit për përpunimin e pemëve dhe perimeve në Kosovë ka dy qasje në nivelin e tregut dhe të shërbimeve, me qëllim që të përmirësojë kapacitetet e prodhuesve dhe të racionalizoj zinxhirin e furnizimeve duke i trajtuar dobësitë kryesore në ambientin aktual.



### 1. në nivelin e tregut:

- Rrit produktivitetin e prodhuesve;
- Rrit shfrytëzimin e kapaciteteve të kompanive të përpunimit;
- Përmirëson bashkëpunimin në mes të përpunuesve dhe qendrave grumbulluese/prodhuesve për sigurimin e lëndës së parë;
- Krijon prodhime të reja që të ofrohen nga ana e përpunuesve;
- Përmirëson kualitetin dhe qasjen në segmente të reja të tregut për përpunuesit e vegjël.

### 2. në nivelin e shërbimeve:

- Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të prodhimeve përmes qendrave të grumbullimit;
- Sigurimi i shërbimeve të zgjeruara nga ana e qendrave të grumbullimit dhe furnizuesve;
- Implementimi i planit dhe hulumtimit të tregut, që ofrohet nga ana e konsulentëve privatë të biznesit;
- Përmirësimi i qasjes së tregut për prodhimet shtëpiake të ofruara përmes distributorëve privat/shitësve me pakicë;
- Përmirësimi i furnizimit më farë.

# *Intervenimet*

*PPSE propozon këto intervenime:*

- 1: Aplikimi i Varieteteve Industriale për Perimet
- 2: Promovimi i Sistemit të Grumbullimit
- 3: Aplikimi i Distributorëve Privat Lokal për Përpunuesit e Vegjël (e shkallës së vogël)
- 4: Promovimi i Plasimit të Prodhimeve Vendore të Përpunuara në Zinxhirët e Shitjes me Pakicë
- 5: Promovimi i Prodhimeve të Përpunuara të Kosovës në Tregjet Ndërkombëtare
- 6: Aplikimi i Prodhimeve të Realizueshme Financiare
- 7: Aplikimi i Shërbimeve të Përbalueshme Financiarisht të Planifikimit/ Menaxhimit
- 8: Aplikimi i Prodhimeve të Përbalueshme Financiarisht të Hulumtimit të Tregut
- 9: Aplikimi i Organeve Private të Certifikimit

Për të trajtuar kufizimet e nën-sektorit të përpunimit të frutave dhe perimeve nëntë ndërhyrjet (intervenime) janë propozuar nga ekipi PPSE. Ndërhyrjet janë projektuar në mënyrë që të arrihet Vizioni i Ndryshimeve për sektorin. Të gjitha ndërhyrjet janë të dizajnuara për të arritur ndërrime 'sistemike' tregut që të sigurojnë qëndrueshmërinë. Ndërhyrjet do të frymëzojnë aktorët e tregut për të trajtuar dobësitë e shërbimit në sektori, i cili pastaj do të zbatojë ndërrime të nevojshme në sistemet e tregut. Çdo ndërhyrje synon ndërrime në nën-sisteme të veçanta që synojnë të arrijnë përmirësime të qëndrueshme.

# Arritjet e deritanishme

## INTERVENIMI 1: Prezantimi i varieteteve industriale



Pasi që ka planifikim të varfër dhe bujqësi kontraktuale të kufizuar, prodhuesit zakonisht nuk specializohen. Bujqit prodhojnë varietete që janë të synuara për tregun e freskët, edhe pse produktet e tyre mund të jenë të destinuara për përpunim. Varietetet e freskëta nuk janë të përshtatshme për përpunim.

Ky intervenim ka për qëllim të fus në përdorim varietete industriale të perimeve për bujqit që prodhojnë për përpunim, të cilat aktualisht nuk janë të përhapura në tregun kosovar. Nga intervenimi përfitojnë të gjithë aktorët e zinxhirit të vlerës, veçanërisht bujqit prodhimet dhe të ardhurat e të cilëve mund të rriten dhe përpunuesit për shkak të rritjes së përdorimit të makinerisë ekzistuese. Varietetet industriale janë më të përshtatshme për përpunim, me potencial për prodhimin e produkteve të cilësisë së lartë me kosto më të ulët.

Ky intervenim implementohet paralelisht me me Intervenimin 2: Promovimi i Sistemit të Grumbullimit. Farat e reja do të futen në përdorim nga furnizuesit hyrës, duke bashkëpunuar me qendrat e grumbullimit për ofrimin e shërbimeve të zgjatura dhe duke kontraktuar fermerët që kanë si rezultat që qendrat e grumbullimit të ofrojnë shërbime shtesë për promovimin e sistemit të grumbullimit definuar në intervenimin e ardhshëm.

PPSE ka arritur sukses inicial me fillimin e implementimit të intervenimit 1. Prodhuesit e perimeve në Kosovë kryesisht i synojnë kanalet e tregut të freskët. Për shkak të prodhimit sezonal (perimet shtëpiake gjinden në treg vetëm për 3-4 muaj) dhe janë të mbi furnizuara gjatë kësaj periudhe sepse prodhuesit nuk mund ti shesin të gjitha produktet e tyre. Në të njëjtën kohë, ekziston kërkesa e rritur për perime nga përpunuesit e ushqimit, por shume pak prodhim është i drejtuar drejt këtij tregu.

**“Një eksperiencë pozitive ishte se përmes mbështetjes së PPSE, një numër i gjerë i aktorëve ka përfituar duke përfshirë – tregtarët e furnizimit, përpunuesit, qendrat e grumbullimit dhe prodhuesit,” Fehim Rexhepi, pronar i AgroCelina, qendra grumbulluese në Xerxe Rahovec. “Veç kësaj, intervenimet e PPSE kanë qenë të fokusuara që aktorët mbështetës të zhvendosin një pjesë të prodhimit të produkteve të freskëta drejt tregjeve të përpunimit. Kjo është ajo çfarë kemi nevojë për zhvillimin e nën sektorit të pemëve dhe perimeve në Kosovë.”**



PPSE, përmes intervenimit të vetë, është duke futur në përdorim varietetet industriale të perimeve që synojnë të zhvendosin një pjesë të prodhimit të perimeve të freskëta në prodhim që ka për synim përpunimin. PPSE këshillon përpunuesit dhe inkurajon që të nënshkruajnë kontrata furnizimi me prodhuesit, aranzhime që kanë munguar më parë. Në fazën fillestare të PPSE, futja në përdorim e domateve industriale është testuar. Partneri i PPSE ka qenë Jonathan, i cili ka furnizuar farën dhe ka ofruar këshilla për njëzet e nëntë prodhues, të cilët

kanë përfshirë pesëmbëdhjete gra. Një përpunues dhe një qendër grumbullimi kanë qenë po ashtu të kyçur. Përpunuesi më i madh, Abi & ELIF 19, ka nënshkruar kontratë furnizimi me qendrën grumbulluese AgroCelina; kurse nga ana tjetër qendra ka nënshkruar kontrata me prodhuesit e domateve.

Si rezultat, njëzet e nëntë prodhues kanë prodhuar dhe i kanë shitur, përmes qendrës grumbulluese, 150 ton domate.

## INTERVENIMI 2: Promovimi i Sistemit të Grumbullimit

Prodhuesit e vegjël, të shpërndarë në gjithë vendin duke ofruar sasi të vogla për konsumatorët e karakterizojnë Kosovën. Furnizimi i jo mjaftueshëm është pengesa kryesore, duke krijuar problem për përpunuesit të cilët kanë nevojë për furnizim të rregullt të lëndës së parë. Për shkak të vështirësive të furnizimit, përpunuesit luftojnë që të shfrytëzojnë kapacitete të tyre dhe përfundojnë me sasi të vogla të produkteve të tyre të përpunuara; plotësimi i kërkesave për të gjithë vitin nga shitësit është problematik.

Tregu ofron shërbime të varfra të grumbullimit dhe përpunuesit nuk shohin përfitime të qarta për bashkëpunim me qendrat grumbulluese, megjithatë qendrat janë ende aktorë të vetëm që mund të grumbullojnë produktet në mënyrë optimale. Për më shumë, përpunuesit nuk kontraktajnë lëndën e parë para kohe.

Për të kapërcyer këtë joefikasitet të tregut, do të ndërmerret një intervenim për promovimin e sistemit të grumbullimit nëpërmjet qendrave grumbulluese. Aktualisht, vetëm 10% e lëndëve të para të përpunuesve blihet përmes qendrave të grumbullimit, ndërsa pjesa e mbetur prej 90% blihet direkt nga fermerët. Intervenimi do të promovojë një sistem grumbullimi nëpër qendrat e grumbullimit, duke zhvilluar shërbime si dhe duke përmirësuar planifikimin dhe kontraktimin që do të stimulojë përpunuesit për të blerë deri në 50% të lëndës së parë nga qendrat grumbulluese. Modeli i qendrave grumbulluese është tipik në rajon, trajton shumë probleme, duke përfshirë edhe kontratat e hershme dhe planifikimin, promovimin e cilësisë dhe racionalizimin e tërë zinxhirit të furnizimit. Intervenimi i sistemit të grumbullimit është i lidhur ngushtë me intervenimin 1: Prezantimi i Varieteteve Industriale.



## Pozita e gruas në përpunimin e ushqimit

Promovimi i fuqizimit ekonomik të grave do të integrohet në intervenime, fuqizimi i grave me krijimin e bizneseve dhe ndryshime të planifikuara të tregut. Aktivitetet që do të përmirësojnë pozitën e grave në sektorin e përpunimit të ushqimit përfshijnë:

- Për fuqizimin e prodhuesve gra, PPSE ka përfshirë shoqatën e biznesit të grave “SHE-ERA” për të promovuar futjen në përdorim të domateve industriale ndër prodhuesit e grave. “SHE-ERA” ka identifikuar prodhuesit gra dhe agronomist femra si këshilltarë teknik. Prodhuesit gra do të shfrytëzojnë lidhjet e tregut nëpërmjet qendrave grumbulluese dhe përpunueseve të përcaktuara.
- Një intervenim specifik është planifikuar për përmirësimin e konkurrencës së përpunueseve të vegjël, që kryesisht janë shoqata të grave. Intervenimi – Prezantimi i Distributorëve Lokal Privat për Përpunues të Vegjël — ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e marketingut të produkteve dhe të mundësoj prodhuesit gra ti qasen tregjeve të reja, posaçërisht në shitoret me pakicë. Fuqizimi i rolit të gruas në zinxhirin e vlerës do të kapërcejë zbrazëtirat në kapacitete menaxheriale, promovim dhe marketing. Distributorë privat pritet të zgjerojnë kanalet e marketingut dhe të i rrisin kapacitetet e marketingut, me gra të përfshira si pjesë e iniciativës. Gratë mund të luajnë rol të rëndësishëm kur trajnohen në marketing/etiketim dhe sigurim të cilësisë.
- Në zinxhirin e vlerës, gratë kanë përfaqësim shumë të varfër në qendrat grumbulluese. Qendrat grumbulluese relativisht ofrojnë punë me aftësi të ulëta, të cilat nuk janë për gra dhe me aftësi të specifikuar. PPSE do të promovojë përfshirje më të madhe të grave in qendra grumbulluese nëpërmjet të intervenimit – Promovimi i Shërbimeve të Grumbullimit. Ekziston potenciali për të ngritur participimin e grave në trajnime të ofruara nga qendrat grumbulluese. Më tutje gratë mund të zhvillohen edhe nëpërmjet shkëmbimit të përvojave, planifikimit të prodhimeve dhe nëpërmjet fushave të tjera. Gratë mund të arrijnë pozita të larta në qendrat grumbulluese dhe të ofrojnë këshilla prodhueseve dhe të ngriten në pozita menaxheriale, që për tani është një tabu. Në supermarkete roli i grave ka ndryshuar gjatë kohës nga punë me aftësi të ulëta në pozita menaxheriale.
- Aktivitete shtesë për promovimin e fuqizimit ekonomik të grave do të integrohen në intervenime të tjera gjatë kohës së zhvillimit. Implementimi i këtyre aktiviteteve do të sigurohet me përfshirjen në marrëveshjet me partneret e intervenimit.

## Qeverisja në nivelin e sektorit (përpunimi i ushqimit)

Konsideratë e veçantë do t'i kushtohet përfshirjes dhe mos diskriminimit të minoriteteve në intervenimet sektoriale. Modele biznesi që ofrojnë vetë-motivimin të brendshëm për aktorët për të rritur pjesëmarrjen dhe për të shmangur çdo diskriminim etnik dhe me baza gjinore do të promovohen.

Megjithatë, nëse kufizime të tilla indentifikohen, konsideratë e veçantë do t'i kushtohet aktiviteteve dhe intervenimeve që i trajtojnë ato. Përparësitë e përgjithshme të qeverisjes sektoriale dhe dobësitë janë paraqitur në tabelën 7.

	Karakteristikat kryesore	Përparësitë kyçe/mundësitë	Dobësitë kyçe/Reziqet	Trendët kryesore
<b>Konteksti jashtë sektorit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në pajtim me rregullat dhe rregulloret</li> <li>- Duke iu nënshtruar masave të efektit disiplinues të regjimit të tregtisë së lirë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sektori është duke pranuar shkallën më të lartë të vëmendjes politike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëdhëniet e përcaktuara në mënyrë të dobët</li> <li>- Mungesë e koordinimit të aktorëve në zinxhirin e vlerës</li> <li>- Mungesa e aftësive dhe njohurive</li> <li>- Mungesa e aftësive të grupimit (ndarjes së teknologjisë dhe "di se si")</li> <li>- Tjera pengesa që mundësojnë biznes</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mundësi për reformë për shkak të ndryshimeve të perceptimit në nivelin politik.</li> </ul>
<b>Aktorët, interesat, dhe stimujt</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Aktor të ndryshëm me pushtete të ndryshme dhe struktura stimujsh</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Disa shtresa të aktorëve përveç institucioneve politike dhe publike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rezistenca për ndryshim e aktorëve kyç</li> <li>- Interesa divergjente/konfliktuale të aktorëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mundësia për reformë për shkak të aktorëve</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>- I nënshtrohen kontrollit të ndryshëm dhe bilancit dhe marrëdhënieve disiplinore</li> <li>- Shumë bartës të ndryshimit</li> </ul>		
<b>Marrëdhëniet e qeverisjes/ llogaridhënies</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përveç marrëdhënieve zyrtare hierarkike, aktorët e sektorit karakterizohen nga marrëdhëniet joformale (të përcaktuara lirshëm)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mix i mire i aktorëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizata të dobëta kontrolli dhe bilanci</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Reforma institucionale (p.sh. rritja e kapaciteteve për të zbatuar në mënyrë të duhur marrëveshjet e tregtisë së lirë);</li> <li>- Reforma tjera që mundësojnë mjedis biznesi me mbështetjen e donatorëve</li> </ul>

## Minoritetet

Projekti PPSE do të synojë komunitetet pakicë në Kosovë, përkatësisht pakicën Serbe në zonat në rajonet veriore dhe jugore të Kosovës. Integrimi, dmth. shënjestërimi i komuniteteve Serbe në rezultatin 1-3, do të jetë primare. Në bazë të analizave, PPSE, parasheh se kjo do të jetë e mundur për pakicën Serbe në jug të Kosovës, të cilat përballen me sfida të ngjashme të tregut (p.sh. lidhjet e dobëta të zinxhirit të vlerës, qasja në financim, tregjet e vogla), si edhe bizneset Shqiptare.

Ondrat e grumbullimit në jug të Kosovës do të përdoren për testimin e modelit të bashkëpunimit, e cila mund të zgjerohet në aktorët e tregut në veri. Fermerët në jug të Kosovës do të inkurajohen për të krijuar lidhje më të ngushta me fabrikat e përpunimit të ushqimit. Një numër i furnizuesve të mundshëm të produkteve "shtëpiake", siç janë produktet e qumështit dhe produktet pyjore jo nga druri do të përfshihen në intervenime.

PPSE është punësues i barabartë. PPSE është kundër diskriminimit dhe racizmit. Punëtorët e PPSE obligohen të mbajnë profil jo-politik në aferat zyrtare dhe publike.



**Kontakt Personi:**

Edona Kurtolli

**Adresa:**

Rr. Major Mehmet Bushi LI 12 nr.1  
10 000 Prishtina, Kosovo

**Tel:** +381 (0) 38 520403

**[www.ppse-kosovo.org](http://www.ppse-kosovo.org)**

**[www.facebook.com/ppse.kosovo](https://www.facebook.com/ppse.kosovo)**

---

Projekti PPSE financohet nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**

Projekti PPSE implementohet nga:



**swisscontact**

